



Biblioteka Kombëtare e Kosovës
"Pjetër Bogdani"



Universiteti "Ukshin Hoti"
Prizren

Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerziteti Prizrena "UKSHIN HOTI"	
Pranuar me datë	30.12.2019
Zyra e pranimit	Nr. i protokollit
308	01-493

Marrëveshje bashkëpunimi
ndërmjet
Bibliotekës Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani"
dhe
Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren

Dy titullarët, Mr. Fazli Gajraku në cilësinë e Drejtorit të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani" dhe Prof. asoc. Dr. Ismet Temaj në cilësinë e Rektorit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, duke u nisur nga vullneti për t'i forcuar dhe thelluar marrëdhëniet nëpërmjet tyre si partnerë, këtu të quajtur palë, bien dakord që të rrisin bashkëpunimin për nxitjen e shkëmbimeve të shumanshme në funksion të zhvillimit ndër-institucional.

Neni 1

Palët do të bashkëndihmojnë në grumbullimin, pasurimin, ruajtjen, mirëmbajtjen e trashëgimisë kombëtare të shkruar dhe të jo-shkruar, si dhe promovimin e trashëgimisë kulturore kombëtare.

Neni 2

Palët do të ushtrojnë ndaj njëra-tjetrës të drejtën e shkëmbimit të botimeve të tyre institucionale bibliografike dhe/ose shkencore.

Neni 3

Palët do të ushtrojnë ndaj njëra tjetrës të drejtën e shkëmbimit të informacionit bibliografik dhe albanologjik.

Neni 4

Palët do të bashkëpunojnë në organizimin e konferencave, seminareve, ekspozitave, panaireve, promovimeve të botimeve të rëndësishme të autorëve dhe/ose studiuesve shqiptarë apo të huaj, veprimtarive të përbashkëta kulturore/shkencore me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar, si:

- nga fusha akademike me interes të përbashkët;
- nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e projekteve të përbashkëta hulumtuese/kërkimore;
- pjesëmarrjen e studentëve dhe stafit në projekte të përbashkëta (me kërkesa të veçanta);
- shfrytëzimin e resurseve të institucioneve (me kërkesa të veçanta);
- trajnime profesionale për zhvillimin dhe menaxhimin e bibliotekës (me kërkesa të veçanta).

Neni 5

Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani" mundëson anëtarësimin e të gjithë studentëve dhe mësimdhënësve të Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren, si lexues të rregullt, në harmoni me vendimin e BKK-së për anëtarësim të lexuesve. Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani" u ofron shërbim të referencave për studentët dhe stafin akademik të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, duke përfshirë këtu informacionin për koleksionet (qasje në mbi 700 mijë tituj), katalogun elektronik dhe manual, mënyrat e hulumtimit, mënyrat e huazimit, si dhe orientimin e përdoruesve të personeli përkatës i Bibliotekës.

Neni 6

Palët bien dakord që realizimi i veprimtarive të kryhet në varësi të burimeve dhe të potencialit të disponueshëm nga secili institucion dhe me marrëveshje specifike.

Neni 7

Çdo nen i kësaj marrëveshjeje mund të ndryshohet, të amendohet ose të revokohet në çdo kohë pas një konsultimi dhe mirëkuptimi reciprok ndërmjet të palëve.

Neni 8

Kjo marrëveshje është e vlefshme për një periudhë 3 (tri) vjeçare nga data e nënshkrimit. Marrëveshja rinovohet automatikisht në mënyrë të heshtur për vitet pasardhëse, kur të dy palët janë dakord për këtë.

Mostinovimi i kësaj marrëveshjeje bëhet nëpërmjet komunikimit zyrtar nga pala e interesuar të paktën 3 muaj përpara përfundimit të saj.

Neni 9

Marrëveshja hyn në fuqi menjëherë.

Nënshkruhet në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Për dhe në emër të

Bibliotekës Kombëtare të Kosovës
"Pjetër Bogdani"

Drejtori

Fazli Gajraku



Për dhe në emër të

Universiteti "Ukshin Hoti"
Prizren

Rektori

Prof. asoc. Dr. Ismet Temaj



Prizren,
më 30 dhjetor 2019